



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BULQIZE
KESHILLI BASHKIAK

Adresa: Lagja "Minatori"

email: bashkiabulqize@hotmail.com

V E N D I M

Nr 44 Date 3 / 05 / 2018

PER

NJE NDRYSHIM NE VENDIMIN NR.86,DATE.07.12.2017 TE KESHILLIT BASHKIAK TE BASHKISE BULQIZE

Ne zbatim te Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", ndryshuar , ne ligjin nr.106/2017, date 30.11.2017 ku shkalla e taksës mbi ndertesat aplikohet si perqindje e baze se taksës, si dhe mbeshtetur ne V.K. M Nr.132 date 7.03.2018 per metodologjine e percaktimit te vleres se tatueshme te pasurise se paluajtshme "ndertesa", Drejtoria e Tatim Taksave ne Bashki i kerkon keshillit Bashkiak te beje ndryshime ne vendimin nr.86, date 07.12.2017, prandaj sa me siper **Keshilli Bashkiak ne mledhjen e tij te dates.03.05.2018 pasi diskutoi dhe analizoi rreth projektit te paraqitur nga Drejtoria e Tatim Taksave ne Bashki per nje ndryshim vendimi te KB Nr.86, date.17.12.2017, me 16 vota pro, asnje kunder dhe asnje abstenim:**

V E N D O S I

1-Te miratoje ndryshime ne paketen fiskale 2018 si me poshte:

- a-uljen e shkalles se taksës per ndertesat deri ne 30% te shumes vjetore te taksës per te gjithë Bashkine Bulqize perfshire dhe njesite administrative :
- b-Per diferencimin e pageses se taksës per ndertesat ndermjet qytetit Bulqize dhe njesive administrative ne varesi te bashkise te reduktohet deri ne 35% te cmimit references mbi bazen e te cilit behet perlllogaritja e taksës krahasuar me cmimin e zones me te afert,perjashtuar zonat rezidenciale.
- c-Perjashtohen nga taksat mbi ndertesat:
-ndertesat e banimit te kryefamiljareve qe trajtohen me ndihme ekonomike,ndertesat e k/familjareve qe perfitojne pension pleqerie ose pension social qe jane me banim ne fshat ose qytet kur familja perbehet vetem nga pensionistet dhe te gjitha pronat,pasurite,ndertesat,ndertesat kulturore etj sipas ligjit nr.106/2017 date 30.11.2017.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e tatim taksave në varësi të Bashkise Bulqizë.

Ky vendim hyn ne fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Diber.

PER KESHILLIN BASHKIAK

SEKRETARI
Agim TUCI



KRYETARI
Gazmend KENGA